



Republika e Kosovës

Republika Kosova
Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë

Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

**STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN
E SEKTORIT PRIVAT 2013-
2017**

Mars 2013



Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1 HYRJE	6
2 ARSYET PËR INTERVENIM	7
2.1 TREGUESIT KRYESOR EKONOMIK	7
2.2 Industria dhe NVM-te	9
2.2.1 Zhvillimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme	9
2.2.2 Investimet e Huaja Direkte ('FDI')	10
2.2.3 Mjedisi i Biznesit, të Bërit Biznes në Kosovë	12
2.3 GJENDJA NË TREGUN E BRENDSHËM	13
2.4 GJENDJA NE TREGTI.....	16
4 KORNIZA LIGJORE, E POLITIKAV E DHE AJO INSTITUCIONALE	17
4.1 INDUSTRIA DHE NVM-TE	17
4.2 TREGU I BRENDSHËM – LËVIZJA E LIRE E MALLRAVE	18
4.3 TREGTIA	19
5 HAPAT E ARDHSHËM	20
5.1 PLANI OPERACIONAL.....	20

Lista e Grafikoneve::

GRAFIKONI 1 RRITJA E BP V-SË REALE DHE KONTRIBUTI I KOMPONENTËVE TË TIJ	8
GRAFIKONI 2 RANGIMI I KOSOVËS NË INDEKSIN E ZHVILLIMIT TË BANKËS BOTËRORE.....	9
GRAFIKONI 3 INVESTIMET NË KOSOVË SIPAS SHTETEVE DHE SEKTORËVE (2007-2011).....	11
GRAFIKONI 4 RAPORTET E BANKËS BOTRORE PËR ZHVILLIMIN E BIZNESIT NË KOSOVË (2013 VS. 2012)	12
GRAFIKONI 5 TREKËNDËSHI 'SHTET-PRODHUES-KONSUMATOR'	14
GRAFIKONI 6 INFRASTRUKTURA E CILËSISË.....	15
GRAFIKONI 7 PLANI STRATEGJIK DHE OPERACIONAL I MTISË PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT NË KOSOVË	20

Lista e Tabelave:

TABELA 1 KOMPANITË KOSOVARE DHE TATIMET	10
TABELA 2 INVESTIMET E HUAJA DIREKTE SIPAS SHTETEVE (VITET 2007 - 2011, NË EUR MIL).....	11
TABELA 3 INVESTIMET E HUAJA DIREKTE SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (VITET 2007-2011, NË EUR MIL)	11
TABELA 4 QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT.....	20



Lista e shkurtesave:

ABV	Akti Evropian për Biznese të Vogla
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës
AMNVM	Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Produktit Vendor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
DAK	Drejtoria e Akreditimit të Kosovës
DIEKP	Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave
DPP	Dialogu Publiko Privat
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KEA	Korporata Evropiane për Akreditim
IAF	International Accreditation Forum
ILAC	International Laboratory Accreditation Cooperation
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimit të Konsumatorëve
IHD	Investimet e Huaja Direkte
KE	Komisioni Evropian
KT	Komitete Teknike
LQMK	Laboratori Qendror i Metrologjisë Kosovës
ILMK	Instituti Metrologjisë Legale të Kosovës
MI	Ministria e Infrastrukturës
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integritet Evropian
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MBPZHR	Ministria Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MTL	Marrëveshje e Tregtisë së Lire
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OSHB	Ofrues të Shërbimeve për Biznesin
PI	Plani Implementues
PIB	Pikë Informative për Biznese
QIB	Qendër e Inovacionit për Biznese
QK	Qeveria e Kosovës
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar



Të nderuar,

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ne bashkëpunim me institucionet relevante ka hartuar Strategjinë e Zhvillimit të Sektorit Privat 2013 – 2017. Dokumenti i cili paraqet koordinimin e aktiviteteve të Ministrisë si pjesë përbërëse e orientimit dhe vizionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zhvillimin e sektorit privat në afat të mesëm, si pjesë e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të Republikës së Kosovës.

Strategjia e Zhvillimit të Sektorit Privat 2013 – 2017 adreson çështjet si: zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, promovimin e investimeve: Tregun e Brendshëm, përkatësisht Lëvizjen e Lirë të Mallrave; si dhe politikat e tregtisë me jashtë. Qëllimi i kësaj strategjie është që të adresojë sfidat si dhe të adoptojë ndryshimet që kanë të bëjnë me zhvillimin e industrisë dhe të sektorit privat, e që janë ndryshimi në kornizën ligjore, atë institucionale dhe të politikave.

Ndryshimet e parapara në Strategjinë e Zhvillimit të Sektorit Privat 2013 – 2017 janë të rëndësishme ngase kanë të bëjnë me zotimin e Ministrisë dhe të institucioneve relevante që të implementojë politika më rigorozë në ngritjen e kapaciteteve për përmirësimin e ambientit të biznesit dhe promovimin e investimeve, e që do ta bënte Kosovën konkurrense me vendet e rajonit. Po ashtu, ngritjen e vetëdijes mbi mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Industriale, si dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të politikave industriale dhe atyre të tregtisë me jashtë.

Duke qenë në linjë me synimet e MTI-se për periudhën respektive, Strategjia fokusohet veçanërisht në adoptimin dhe implementimin e politikave që do të kontribuonin në përmirësimin e prodhimtarisë vendore dhe në ngritjen e konkurrueshmërisë së Kosovës në tregun evropian.

Vlen të theksohet që në përpilimin e këtij plani jemi përpjekur t'i përfshijmë edhe sugjerimet që rrjedhin nga orientimi i përgjithshëm i Republikës së Kosovës për Integritet Euro-Atlantike.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të vazhdojë punën e vet duke u bazuar në udhëzimet që rrjedhin nga ky dokument i rëndësishëm strategjik, gjithmonë duke mbetur e përkushtuar në qëllimin e përgjithshëm për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Republikës së Kosovës.

Mimoza Kusari-Lila

Zv. Kryeministre/Ministre e Tregtisë dhe Industrisë



Përmbledhje Ekzekutive

Strategjia e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për Zhvillimin e Sektorit Privat në përpjekje për të rritur punësimin dhe reduktuar varfërinë, synon të krijojë një sektor privat globalisht konkurrent.

Strategjia ofron një kornizë për intervenimet e mundshme nga niveli qendror dhe lokal qeveritar, sektori privat dhe ai jo-qeveritar. Këto intervenime do të inspirojnë ndryshimet e nevojshme për arritjen e një mirëqenie shoqërore, infrastrukturë moderne, zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, si dhe sigurimin e shërbimeve efikase publike.

Kjo strategji është e organizuar në tri shtylla:

- (1) Zhvillimin, përkrahjen dhe promovimin e investimeve dhe bizneseve;
- (2) Permiroimin e Lëvizjes së Lirë të Mallrave apo rregullimin e Tregut të Brendshëm; dhe
- (3) Avandimin e Politikave Tregtare

Kjo Strategji bazohet në shtyllën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës (2011 – 2014). Kjo shtyllë potencon se *“gjenerator kryesor i rritjes ekonomike do të jenë investimet private dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i ndërmarrësisë...”*¹ Gjatë hartimit të kësaj strategjie për bazë është marrë Plani i Veprimit të Vizionit të Zhvillimit Ekonomik të Kosovës (2011 – 2014), i cili, në mes tjerash, përcakton plotësimin e legjislacionit bazë që krijon kushte për stimulimin e investimeve dhe heqjen e barrierave administrative si prioritete për rritjen e investimeve dhe përkrahjen e zhvillimit të sektorit privat.

¹ Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës (2011 – 2014)



1 Hyrje

Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017 e hartuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë paraqet elementet e ndërlidhura me aktivitetet e sektorit që kjo ministri mbulon, e që janë pjesë e orientimit dhe vizionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Në hartimin e këtij dokumenti janë konsultuar në vazhdimësi Ministritë tjera që janë institucione mbështetëse të zhvillimit të këtij Sektori, dhe në të njëjtën kohë janë përfshirë sugjerimet që rrjedhin nga orientimi i përgjithshëm i Republikës së Kosovës për integritet euro-atlantik. Për më shumë informacione në lidhje me metodologjinë e hartimit të Strategjisë në fjalë ju lutem referojuni Aneksit nr. 1 (Vëni re: Aneksët janë të paraqitura në dokument ndaras).

Dokumenti në fillim paraqet fakte mbi rendesinë e Sektorit, mandej gjendjen e përgjithshme në Sektor duke theksuar arsyetimin për intervenim, nga ku janë nxjerre edhe qëllimet dhe objektivat përmes të cilave strategjia parasheh zhvillimin e këtij Sektori.

Në vijim janë të paraqitura qëllimet strategjike, nën-qëllimet dhe objektivat përmes të cilave do të implementohet kjo Strategji, dhe mbi të cilat do të vlerësohet implementimi i kësaj Strategjie.

Strategjia e Zhvillimit të Sektorit Privat ::: Qëllimet strategjike dhe nën-qëllimet

Industria dhe NVM-të

1 Shtet dhe Ndërmarrje Globalisht Konkurruese

- 1.1 Orientimi në Sektor Strategjik të Industrisë, duke i dhënë prioritet prodhimit dhe eksportit
- 1.2 Përkrahja e vazhdueshme e zhvillimit të aftësive teknike, inovative dhe menaxheriale
- 1.3 Përmirësimi i vazhdueshëm i qasjes në financa
- 1.4 Mbrojtja e Pronës Industriale

2 Promovimi i Investimeve dhe Eksporteve

- 2.1 Ngritja e bashkëpunimit me komunitetin e biznesit
- 2.2 Rritja e aktiviteteve në promovimin e investimeve brenda dhe jashtë vendit
- 2.3 Monitorimi i mbarëvajtjes së investimeve të huaja
- 2.4 Mbrojtja e Investitorëve të Huaj

Lëvizja e Lirë e Mallrave

3 Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës së cilësisë

- 3.1 Zhvillimin e mëtejshëm të Metrologjisë ligjore dhe industriale
- 3.2 Rritja në vazhdimësi e TVK-ve të akredituara
- 3.3 Sigurimi i kontinuitetit të plotësimit të kërkesave të standardeve
- 3.4 Rritja e numrit të standardeve të miratuara dhe ngritja e vetëdijes në implementimin e tyre.

4 Siguria e Produkteve industriale jo-ushqimore

- 4.1 Ngritjen e vetëdijes së konsumatorëve



4.2 Mbikëqyrje të tregut, përkatësisht produkteve industriale që qarkullojnë në tregun vendor

Politikat Tregtare

5 Zhvillimi i Politikave Tregtare në drejtim të përmirësimit të bilancit tregtar të vendit

- 5.1 Përkrahja e sektorëve me potencial eksportues
- 5.2 Liberalizimi i tregut dhe zbatimi i marrëveshjeve për tregti të lirë
- 5.3 Anëtarësimi në organizatat relevante për tregti, duke i dhënë prioritet OBT-së

2 Arsyet për intervenim

2.1 Treguesit kryesor ekonomik

Treguesit makroekonomikë sugjerojnë se Ekonomia e Kosovës ka pasur progres gjatë vitit 2011. Ekonomia e Vendlit gjatë vitit 2011 ka shënuar rritje me një normë vjetore prej 5.3%, që kryesisht vlerësohet të jetë rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme dhe të jashtme. Sidoqoftë koeficienti i rritjes është ende i vogël në krahasim me atë të planifikuar, rreth 7 % rritje vjetore.

Konsumi i përgjithshëm ishte kontribuues kryesor në rritjen e Bruto Produktit, i cili vlerësohet se është rritur për 3.4% nga vlera e përgjithshme, ku konsumi privat është rritur me një normë prej 4.4% ndërsa ai publik me normën prej 3.2%.

Bazuar në të dhënat e sektorit financiar, investimet e përgjithshme kanë shënuar rritje prej 6% ku ato private janë rritur për 3.8% ndërsa publiket janë rritur për 9.4%


Shpenzimet totale të Qeverisë gjatë vitit 2011, me një ngritje prej 9.1%, arritën vlerën prej €1.388 milion, ndërsa shpenzimet kapitale shënuan rritje po ashtu prej 9.1% krahasuar me vitin paraprak. Indeksi i Çmimit të Konsumatorëve (IÇK) ka pësuar rritje në vitin 2011 krahasuar me vitin paraprak, këtë duke kapur figurën prej 7.3% nga 3.5% sa ishte në vitin 2010.

Sa i përket Tregtisë me Jashtë, eksportet në fund të vitit 2011 shënuan vlerën prej €312.5 Milion apo rritje vjetore prej 6.3%, ndërsa importet shënuan rritje prej 15.6%. Nga vendet e BE-se, Kosova ka partner kryesor tregtar Italinë dhe Gjermaninë, ndërsa nga vendet e CEFTA-se partner kryesor ka Maqedoninë dhe Shqipërinë. Nga vendet e tjera të botes partner tregtare kyç i Kosovës është Kina, përcjellë nga Zvicra, India dhe Turqia. Mbetet sfidues bilanci negativ tregtar i cili për vitin 2011 sipas të dhënave nga Departamenti i Tregtisë ishte 2.1 Miliard.

Me poshtë është i paraqitur një grafikoni që në periudhën kohore 2009-2015 parasheh rritje reale të BPV-se dhe kontributin e komponentëve të tij.



Grafikoni1 Rritja e BPV-së reale dhe kontributi i komponentëve të tij



Burimi1 Departamenti Makroekonomik, Ministria e Financave, Qeveria e Republikës së Kosovës

Sfidues mbetet fakti që papunësia mbërriu deri në 47% në 2010² dhe është ende më e lartë në viset rurale. Përafërsisht 30 000 të rinjë hyjnë në tregun e punës çdo vit. Siq njifet në shumë dokumente strategjike të Kosovës, papunësia, varfëria e ndërlikur dhe GNP (€1,795 për kokë banori në 2009) janë problemet më të mëdha në Kosovë dhe ka një nevojë urgjente për rritje ekonomike shtesë për të krijuar më shumë vende pune. Ne kete drejtim, politikat efektive për zhvillimin e sektorit privat do të luajnë një rol krucial në lehtësimin e një rritje ekonomike të udhëhequr nga eksportet dhe investimet.

Me tutje, në vlerësimin e vitit 2012 të Bankës Botërore, Kosova rankohet si shtet me 'të ardhura të ulëta të mesme'. Implementimi me sukses i kësaj strategjie do të veprojë si katalizator i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe shoqëror duke mundësuar që Kosova deri më 2020 ti bashkangjitet shteteve me 'të ardhura të sipërme të mesme' dhe deri më 2030 – atyre me 'të ardhura të larta' (tabela në vijim).

² [Banka Botërore](#)



Grafikoni 2 Rangimi i Kosovës në indeksin e zhvillimit të Bankës Botërore

Shtete të selektuara në rajonin 'Evropë dhe Azi Qendrore'		
Shteti (rradhitje alfabetike)	Grupi i të ardhurave	Viti
Austria	Të ardhura të larta	2030
Estonia	Të ardhura të larta	
Gjermania	Të ardhura të larta	
Kroacia	Të ardhura të larta	
Republika Qeke	Të ardhura të larta	
Bosnja dhe Hercegovina	Të ardhura të sipërme të mesme	2020
Bullgaria	Të ardhura të sipërme të mesme	
Maqedonia	Të ardhura të sipërme të mesme	
Serbia	Të ardhura të sipërme të mesme	
Turqia	Të ardhura të sipërme të mesme	
Kosova	Të ardhura të ulëta të mesme	2012
Shqipëria	Të ardhura të ulëta të mesme	

Burimi 2 Banka Botërore: Indikatorët e Zhvillimit

2.2 Industria dhe NVM-te

2.2.1 Zhvillimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme

Ekonomia e Kosovës që nga viti 1999 ka qenë kryesisht e mbështetur nga ndihma ndërkombëtare, sektori publik dhe remitancat (BB, 2010). Roli i sektorit privat, e posaçërisht i NVM-ve ka qenë relativisht i dobët. Pavarësisht kësaj, Kosova është ende në fazën e tranzicionit ku ndërmarrësia dhe krijimi i bizneseve të vogla pritet të luajnë rol të rëndësishëm në rrugën drejt një ekonomie moderne të tregut të lirë dhe si rrjedhim edhe drejt zhvillimit dhe rritjes ekonomike.

Kosova vuan nga bilanci negativ i pagesave ku importet dominojnë dukshëm eksportet. Kjo është kryesisht për shkak të faktit që NVM-të e Kosovës nuk janë aq konkurrense në nivel ndërkombëtar. NVM-të eksportuese të dobëta, jo konkurruese, pengojnë kontributin e mëtutjeshëm të NVM-ve në BPV, krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike në përgjithësi.

Për shkak të mjedisit jo të favorshëm për biznes që ka dominuar në të kaluarën, të mungesës së kulturës kreative të ndërmarrësisë dhe mungesës së investimeve në Hulumtim dhe Zhvillim, Kosova ka mungesë të firmave inovative me rritje të shpejtë, të cilat janë kontribuesit kryesor në krijimin e vendeve të punës në ekonominë e zhvilluar perëndimore.

Mbi 50% e të gjitha NVM-ve që operojnë në sektorin tregtar karakterizohen me investime të vogla dhe joproduktive. Ky model i pasuar me qasjen kopjuese "edhe unë" të bizneseve të reja, kufizon kapacitetin e sektorit të NVM-ve për gjenerimin e vendeve të punës. Në kuptim të zhvillimit të politikave, raporti "Indeksi i Politikave për NVM-te 2009" tregon se Kosova për arsye të ndryshme, ende është në fazën e kompletimit të kërkesave themelore institucionale, ligjore dhe rregullative që kanë të bëjnë me politikat e NVM-ve.

Nga hulumtimet që janë zhvilluar me ndërmarrjet, mikro të vogla dhe të mesme, konkretisht duke ju referuar hulumtimit të 800 NVM-ve të realizuar në fund vitit 2010 dhe fillim të vitit 2011 rezultatet tregojnë se pengesat kryesore në zhvillimin e NVM-ve të ndërlidhura me krijimin e vendeve të punës janë si ne vijim:

- Qasja në financa (kreditimet, kamatat, afatet kohore);



- Situata e përgjithshme ekonomike;
- Energjia elektrike;
- Konkurrenca jo-lojale (mes ndërmarrjeve vendore);
- Rrethanat e jashtme tregtare, etj.

Veshtiresit per qasjen ne financa dhe implementim te legjislacionit theksohen edhe ne raportet e progresit te vitit 2010, 2011 si dhe te raportit te studimit te fizibilitetit poashtu.

Ndersa, mungesen e konkurrueshmërisë e tregon fakti qe mbi 100,000 biznese janë të regjistruara në Kosovë, mirëpo vetëm rreth 18,000 deklarojnë tatime pranë Administratës Tatimore të Kosovës (shih tabelën në vijim).

Tabela 1 Kompanitë Kosovare dhe Tatimet

Kompanitë Kosovare ::: Tatimet (viti fiskal 2011)										
Kompanitë sipas nr. të punëtorëve	Nr. of companies (FY 2011)				Δ Diskrepanca	Gjithsej nr. i punëtorëve		Taksat personale të paguara		
	(Agjencia për Regjistrim të Bizneseve)		(Admin. Tatimore)			(Admin. Tatimore)				
Total →	100,770	100%	18,170	100%	82,600	-82.0%	100,852	100%	€ 16,438,591	100%
Mikro (1 - 9)	99,190	98.4%	16,279	89.6%	82,911	-83.6%	41,333	41.0%	€ 3,476,914	21.2%
Të vogla (10 - 49)	1,390	1.4%	1,605	8.8%	(215)	15.5%	30,609	30.4%	€ 5,664,451	34.5%
Të mesme (50 - 249)	190	0.2%	286	1.6%	(96)	50.5%	28,910	28.7%	€ 7,297,227	44.4%

Burimi3 ARBK / MTI, ATK / MF

2.2.2 Investimet e Huaja Direkte ('FDI')

Duke pasur parasysh klimën e përmirësuar të biznesit, ambient të qëndrueshëm makroekonomik dhe mundësi të shkëlqyer në të gjithë sektorët e ndryshëm të biznesit, Kosova është duke u bërë një vend gjithnjë e më tërheqës për të bërë biznes. Si rezultat, interesi i investitorëve të huaj është rritur vazhdimisht gjatë viteve të fundit. Kosova ka tërhequr mbi 1 miliard Investime të Huaja Direkte (IHD) në tre vitet e fundit. Pas një kulminacioni në vitin 2007, me 440 milion euro të IHD-ve, një rënie e vogël është parë në vitin 2008 dhe 2009, kjo kryesisht për shkak të ndikimit të krizës globale financiare. Në vitin 2011 Kosova vazhdoi me trend pozitiv të rritjes së IHD-ve. Nga shtetet tjera, rritje kryesisht ka pasur nga Anglia dhe Turqia. Në tabelën e mëposhtme janë të dhënat për vëllimin dhe origjinën e Investimeve të Huaja Direkte për 5 vitet e fundit.

Sa i përket IHD-ve në Kosovë sipas formës së investimit, 73.2% e tyre janë investime kapitale, të cilat deri në Shtator të vitit 2011 ishin për 22.0% më të larta krahasuar me një vit më parë. Në kuadër të IHD-ve të pranuar në Kosovë, 14.2 % janë në formë të investimeve të fitimit të pashpëmdarë, ndërsa investimet e formave tjera (kryesisht të përbëra nga kreditë ndërmjet ndërmarrjeve) janë 12.6 % dhe kanë shënuar rritje të theksuar nga 13.6 milionë euro sa ishin në Shtator 2010 në 36.9 milionë euro deri në Shtator 2011.

Dy tabelat dhe grafikonet në vijim tregojnë për investimet e huaja direkte sipas shteteve dhe aktivitetit ekonomik në vlerë investuese në euro milion.



STRATEGJIA MINISTRISË SË TREGTISË DHE INDUSTRIËS PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT 2013-2017

Tabela 2 Investimet e huaja direkte sipas shteteve (vitet 2007 - 2011, në EUR mil)

Investimet e huaja direkte sipas shteteve (vitet 2007 - 2011, në EUR mil)																	
Shteti		Gjithsej ↓		2007		2008		% Δ	2009		% Δ	2010		% Δ	2011		% Δ
Gjithsej →		1,855.0	100%	440.7	100%	366.5	100%	-16.8%	287.4	100%	-21.6%	365.8	100%	27.3%	394.6	100%	7.9%
1	Gjermania	325.4	18%	48.1	10.9%	44	12.0%	-8.5%	75.2	26.2%	70.9%	91.5	25.0%	21.7%	66.6	16.9%	-27.2%
2	Anglia	278.0	15%	116.2	26.4%	36.6	10.0%	-68.5%	6.2	2.2%	-83.1%	38.9	10.6%	527.4%	80.1	20.3%	105.9%
3	Sllovenia	201.5	11%	56.2	12.8%	44.3	12.1%	-21.2%	50.8	17.7%	14.7%	34	9.3%	-33.1%	16.2	4.1%	-52.4%
4	Austria	142.9	8%	35.4	8.0%	51.3	14.0%	44.9%	15.5	5.4%	-69.8%	21.1	5.8%	36.1%	19.6	5.0%	-7.1%
5	Zvicra	130.5	7%	9.7	2.2%	32.1	8.8%	230.9%	22.7	7.9%	-29.3%	35.1	9.6%	54.6%	30.9	7.8%	-12.0%
6	Holanda	107.5	6%	41.2	9.3%	22.5	6.1%	-45.4%	15.1	5.3%	-32.9%	14.5	4.0%	-4.0%	14.2	3.6%	-2.1%
7	Turqia	83.3	4%	5.4	1.2%	23.8	6.5%	340.7%	14.5	5.0%	-39.1%	4.9	1.3%	-66.2%	34.7	8.8%	608.2%
8	Shqipëria	80.1	4%	3.4	0.8%	21.9	6.0%	544.1%	23.3	8.1%	6.4%	20.3	5.5%	-12.9%	11.2	2.8%	-44.8%
9	Tjera	505.8	27%	125.1	28.4%	90	24.6%	-28.1%	64.1	22.3%	-28.8%	105.5	28.8%	64.6%	121.1	30.7%	14.8%


Burimi4Banka Qendrore e Kosovës

Tabela 3 Investimet e huaja direkte sipas aktivitetit ekonomik (vitet 2007-2011, në EUR mil)

Investimet e huaja direkte sipas aktivitetit ekonomik (vitet 2007-2011, në EUR mil)																
Investimet	Gjithsej ↓		2007		2008		% Δ	2009		% Δ	2010		% Δ	2011		% Δ
Gjithsej →	1,855.6	100.0%	440.7	100.0%	366.5	100.0%	-16.8%	287.4	100.0%	-21.6%	365.8	100.0%	27.3%	395.1	100.0%	8.0%
1 Shërbime financiare	393.5	21.2%	101.8	23.1%	127.9	34.9%	51.1%	73.3	25.5%	-26.9%	43.2	11.8%	-53.7%	47.4	12.0%	1.6%
2 Ndërtimi	312.1	16.8%	5.3	1.2%	13.6	3.7%	208.2%	34.5	12.0%	224.4%	101.7	27.8%	131.7%	157.1	39.7%	43.0%
3 Prodhimi	304.3	16.4%	39.7	9.0%	22.0	6.0%	-33.3%	49.2	17.1%	185.0%	143.8	39.3%	129.8%	49.7	12.6%	-68.0%
4 Patundshmëritë	272.4	14.7%	30.9	7.0%	61.6	16.8%	140.0%	42.8	14.9%	-11.3%	52.3	14.3%	-4.0%	84.8	21.5%	50.1%
5 Trans. dhe Telekom.	205.1	11.1%	129.1	29.3%	50.6	13.8%	-52.9%	21.3	7.4%	-46.4%	2.9	0.8%	-89.2%	1.2	0.3%	-62.7%
6 Minierat	67.1	3.6%	41.4	9.4%	17.2	4.7%	-50.0%	6.9	2.4%	-48.9%	1.1	0.3%	-87.5%	0.4	0.1%	-67.2%
7 Tjera	301.2	16.2%	92.6	21.0%	73.7	20.1%	-4.3%	59.5	20.7%	3.0%	20.9	5.7%	-72.5%	54.6	13.8%	142.4%

Burimi5Banka Qendrore e Kosovës

Grafikoni 3 Investimet në Kosovë sipas shteteve dhe sektorëve (2007-2011)



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Nga grafikoni i mësipërm mund të shihet që marrë për bazë tri vitet e fundit, IHD me se shumti kishte në ndërtim dhe patundshmëri duke u përcjellë pastaj me prodhim dhe shërbime financiare. Ndërsa në vitin 2007 dhe 2008 shihet që prinin sektori i Transportit, ai i Telekomunikacionit si dhe ai i Shërbimeve Financiare, ishin sektoret që thithen me se shumti IHD.

Sa u përket sfidave të përgjithshme, institucionet që mbështesin zhvillimin e sektorit privat në Kosovë përballen me kapacitete të pamjaftueshme për promovim të investimeve të huaja, sidomos, duke pasur parasysh konkurrencën e ashpër nga vendet e tjera të rajonit në këtë drejtim.

Gjithashtu, ka vështirësi të shumta në zbatimin e ligjeve që lidhen me këto fusha, por edhe me ato të tregut të brendshëm dhe tregtisë. Sa i përket fushës së industrisë (ku veprojnë rreth 1,200 biznese,




në sektorë të ndryshëm), struktura e këtyre sektorëve vazhdon të përballet me nivel të ulët të zhvillimit teknologjik dhe të 'know how', humbjen e tregjeve tradicionale në BE dhe jashtë saj, pastaj privatizimi i ndërmarrjeve publike i zhvilluar jo mire ka bërë që shumë ndërmarrjeve industriale t'u ndërrohet destinimi. Gjithashtu vlen të theksohet se Qeveria nuk është duke ofruar mjaft stimulim për bizneset, p.sh. Qeveria e Maqedonisë stimulon direkt investimin deri në 50% të financimit si dhe ofron pushime tatimore (tax breaks), këtë deri në 10 vite. Pushimi tatimor do të ishte stimulim shumë i mirë sidomos përperiudhën fillestare të bizneseve. Paketë stimuluese ofron edhe Qeveria e Serbisë duke ofruar stimulime deri në 10,000 Euro për punë që krijohet në qytetet me të varfra. Mungesa e paketave stimuluese për fillim të biznesit bën që të humbim edhe investitorë të huaj. Një shembull është kur para pak kohe një investitor Turk i interesuar të investoj është vendosur në Bulgari në vend të Kosovës për faktin që Qeveria e Bullgarisë i ka ofruar hapësirë punë për 5 vite pa qera.

2.2.3 Mjedisi i Biznesit, të Bërit Biznes në Kosovë

Në Raportin e Progresit të KE-së për Kosovën, të vitit 2010 dhe 2011, qasja e kufizuar në financa është identifikuar si barrierë në zhvillimin e NVM-ve.

Duke e pasur parasysh këtë raport si dhe rekomandimet e tjera siç ishte ai i Bankës Botërore për të Bërit Biznes, MTI ka pranuar se për largimin e pengesave për investime të biznesit, dhe krijimin e vendeve të reja të punës, nevojiten më shumë përpjekje në të gjitha nivelet e qeverisë dhe se thjeshtësimi i administratës është çelës i të bërit biznes. Kryesisht përkëtë qëllim është themeluar dhe funksionalizuar Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik. Këto përpjekje përbëjnë thelbin e Objektivit Strategjik nr. 1 dhe si të tilla kanë rolin kryesor në konceptin e ri zhvillimor të parapare në Strategjinë e Zhvillimit të Sektorit Privat. Sfida këtu është ndërtimi dhe integrimi i komponentëve të reformës rregullative, dhe në përgjithësi të iniciativave të ndryshme në proces, që janë të ndërlidhura me integrimet evropiane, investimet, reformat ligjore dhe të konkurrencës.

Grafikoni 4 Raportet e Bankës Botërore për Zhvillimin e Biznesit në Kosovë (2013 vs. 2012)





Ne këtë drejtim, vitin e fundit janë reduktuar një numër i procedurave kyçe të cilat kanë rezultuar në përmirësim të mjedisit të biznesit në Kosovë.

Poashtu, ne tre vitet e fundit është bërë një reformë e madhe tatimore dhe riorganizimi i arkëtimit të TVSH-së përmes arkave fiskale. Këta ishin hapat kryesor në tentimet për uljen e shkallës së informalitetit të bizneseve dhe për të provuar përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet komunitetit të biznesit dhe Qeverisë. Kjo është bërë në përpjekje të zvogelimit të informalitetit i cili sipas raportit të fizibilitetit mbetet prapë i lartë, ku strategjia ka parapare hapa në adresimin e metutjeshëm të këtij problemi.

Kosova përfiton nga Marrëveshja Preferenciale me BE-ne që nga fundi i Dhjetorit 2011. Gjithashtu, që nga viti 2008 Kosova përfiton nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara Amerikane përmes Sistemit Gjeneral të Preferencave për mëse 4,000 produkte. Përkunder këtij fakti, sipas studimeve del që bizneset kosovare nuk i shfrytëzojnë mirë keto preferenca të garantuara.

Aktualisht rreth 1,200 biznese zhvillojnë aktivitete të ndryshme neper sektorë të industrisë ku nga këto rreth 14% kanë punuar edhe para vitit 1999. Kjo strukture e këtyresektorëve ka ende nivelin e ulët të zhvillimit teknologjik know-how-technology, ka humbje të tregjeve tradicionale në BE dhe jashtë saj, pastaj privatizimi i shume industrive ua ka ndërruar destinimi i aktiviteteve.

Sa i përket mbrojtjes së pronës industriale apo krijimeve, duke pasur parasysh numrin e vogël të aplikimeve nga bizneset, vërehet që qytetaret dhe bizneset e Kosovës nuk janë mirë të informuar për rendesinë e mbrojtjes së krijimeve të tyre. Për të avancuar në këtë sferë, strategjia parasheh rritjen e aktiviteteve në ngritjen e vetedijes së bizneseve në veqanti, për rendesinë e mbrojtjes së krijimeve të tyre, si dhe ngritjen e bashkëpunimit me institucionet relevante, vendore dhe ndërkombetare.


2.3 Gjendja në Tregun e Brendshëm

2.3.1 Infrastruktura e Cilësisë është bazë e nevojshme dhe e domosdoshme për zhvillimin e teknologjisë, prodhimin, shërbimet dhe tregtinë. Standardet janë grupe specifikimesh teknike që përdoren si rregulla ose udhëzime për të përshkruar karakteristikat e materialeve, produkteve, shërbimeve ose proceseve. Cilësia arrihet me anë të testimit të materialeve dhe produkteve. Testet zhvillohen nga një rrjet laboratorësh që operojnë sipas rregullave dhe rregulloreve të bazuara në standarde. Metrologjia siguron shërbime që garantojnë se pajisjet e përdorura në testime kryejnë matje të sakta. Për më tepër, Akreditimi është gjithashtu pjesë përbërëse e Sistemit të Infrastrukturës së Cilësisë, dhe punon me idenë që të gjitha pjesët e Sistemit të Infrastrukturës së Cilësisë të operojnë sipas standardeve përkatëse me anë të vlerësimit të kompetencës së Organeve të Vlerësimit të Konformitetit.

Po ashtu nga analiza e sektorit vërehet se eshtenje kombinim i mirë në mes shtetit funksional, prodhuesve konkurrentë dhe konsumatorëve të vetëdijshëm siguron efikasitet në treg, cilësi dhe qëndrueshmëri në konsum dhe prodhim. Përfundimisht siguron mirëqenie shoqërore, ekonomike dhe politike (figura në vijim).



Grafikoni 5 Trekëndëshi 'Shtet-Prodhuar-Konsumator'



Për të arritur deri në një 'eko-sistem' i mirëfilltë 'shtet-prodhues-konsumatorë' nevojitet një infrastrukturë kombëtare e qëndrueshme e cilësisë e cila do të sigurojë rritje të vazhdueshme të konkurrueshmërisë së sektorit privat dhe tregtisë duke përmirësuar vazhdimisht mirëqenien e konsumatorëve.

Me hapjen e ekonomive drejt tregjeve botërore konsiderohet që ekzistenca e **Infrastrukturës** së zhvilluar institucionale të **Cilësisë** është parakusht për zhvillim të suksesshëm.³ Infrastruktura e cilësisë është vitale, në mes tjerash, për:

- ✓ rritjen e konkurrueshmërisë së industrisë kombëtare;
- ✓ rritjen e investimeve të huaja në vend ('FDI') dhe eksporteve;
- ✓ mbrojtjen e konsumatorëve në tregun e brendshëm dhe të jashtëm;
- ✓ sistemin kombëtar të inovacionit, etj.

Zhvillimi dhe qëndrueshmëria e infrastrukturës së cilësisë n'varet në mes tjerash nga politikat ekonomike deri te zbatimi i standardeve ndërkombtare (praktikave të mira) mbi sigurinë e cilësisë së shërbimeve dhe produkteve. Grafikoni në vijim përfshin fushat kryesore të cilat përbëjnë infrastrukturën e cilësisë.

³ Alexander Speed, Këshilltar për Politika Ekonomike dhe Zhvillim të Sektorit Privat, GIZ – Kosovë, Punëtori më 22 Nëntor 2012, Prishtinë

Grafikoni 6 Infrastruktura e Cilësisë



Si referencë për të dëshmuar rëndësinë e ndërtimit të një infrastrukture të qëndrueshme të cilësisë, rritja ekonomike e Gjermanisë influencohet fuqishëm nga standardizimi. Konsiderohet që qereku i rritjes vjetore të Gjermanisë bazohet në përpjekjet e standardizimit. Inputi vjetor në standardizim është përafërsisht 700 mil euro. Ndërsa, benefiti ekonomik vjetor i Gjermanisë përmes standardizimit konsiderohet të jetë rreth 20 miliardë euro, që është 1% e BPV.⁴

Nga Nëntori i vitit 2011, DAK është anëtar ne Korporatën Evropiane të Akreditimit (EA) si anëtar shok, si dhe DAK është anëtar me te drejta te plota në IAF (Forum in ndërkombëtar të akreditimit) dhe në ILAC (Organizata Ndërkombëtare e Akreditimit të Laboratorëve)

Ne kuadër te vlerësimit te konformitetit janë te akredituar 19 laborator testues dhe një Trupë Inspektues dhe janë ne procedurë të akreditimit edhe 7 Trupa për Vlerësim të konformitetit.

Sa i përket Metrologjisë, labororet nuk jane ende funksional dhe mbikqyrja metrologjike nuk është e efektit te duhur. Përkundër faktit se ekzistojnë dikund 20 laboratorë testues dhe kalibrues, ata ende nuk mjaftojnë as për se afërmi për nevojat e kompanive dhe tregut te brendshëm. Shfrytëzim i pamjaftueshëm i pajisjeve kalibruese, për me tej vërehet mungesë e stafit te mjaftueshme dhe profesional e qe përveç tjerash ka sjellur vonesa ne bazhdarimin e peshoreve, njehsorëve dhe volum metrave. Prandaj, strategjia ka ne fokus rritjen e mbikqyrjes metrologjike duke menduar qe kjo do ven ne vemendje dhe ngris rendesine e metrologjise.

⁴ DIN (2000): Gesamtwirtschaftlicher Nutzen der Normung - Zusammenfassung der Ergebnisse der DIN-Studie aus dem Jahr 2000
http://www.ebn.din.de/sixcms_upload/media/2929/GNN_zusammenfassung_brosch.pdf



Mbikqyrja e Tregut dhe Konsumatori - Aktualisht tregu mbikëqyret duke bere inspektime neper biznese, inspektimet kryhen nga Inspektorati Qendror ne MTI dhe 7 zyrat rajonale. Ne këtë dikaster vërehet mungesa e kapaciteteve administrative dhe koordinim jo i duhur i trupave inspektuese te fushave te caktuara. Mandej, shpesh here vërehet edhe ngatërimi i kompetencave, si për shembull, Inspektorati i Tregut me atë te Metrologjisë, fakt i cili ndikon negativisht ne rrjedhën e monitorimit te tregut te brendshëm. Ende mungon informimi, vetëdijesimi, edukimi dhe arsimimi i qytetareve për te drejtat qe ata kane si konsumatorë, poashtu, nevojitet përfshirje me e madhe e OJQ-ve te cilat trajtojnë fushën e konsumatoreve. Problem ne vete paraqesin edhe vonesat e AUV-it ne hartimin e rregulloreve nga fusha e sigurisë se produkteve ushqimore.

Zyrtareve u mungojnë njohuritë në Menaxhim të Cilësisë, në veçanti njohuritë qe parashihen sipas kërkesave të standardeve të serisë SK ISO 9,000; serisë SK ISO/IEC 17,000; EN 45000; SK ISO 22000; dhe SK ISO 14000. Kërkesat që duhet përmbushur në pajtim me direktivat e qasjes së re dhe rregulloreve të BE-së mbështesin anëtarësimin në mekanizmat ndërkombëtare të tri shtyllave kryesore të infrastrukturës së cilësisë, si dhe plotësimin e kriterëve për nënshkrimin e marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, si dhe anëtarësimin në OBT dhe mekanizmat rajonale e ndërkombëtare.

Ne Akreditim vërehet qe mungojnë trupa qe vlerësojnë konformitetin për produktet industriale, dhe se jo te gjithë trupat qe vlerësojnë konformitetin, siç është ai për Homologim te Automjeteve, janë nen mbikëqyrje te DAK-ut. Kjo bën qe te këtë një mbikëqyrje jo efektive te sistemit te konformitetit. Strategjia si e tille parasheh rritje te numrit te TVK-ve te akredituara dhe monitorim te mirefilltë te tyre.

Per nje inspektim te mirefillt te produkteve qe qarkullojnë ne treg nevojitet bashkëpunim i mirefilltë nderinstitucional dhe rajonal, sidomos ne shkembimin e informatave. Sa i perket bashkëpunimit rajonal, Inspektorati nuk është ende i integruar ne sistemin RAPEX, sistem ky i shkembimit te Informacioneve per produktet e rrezikshme (jo konforme). Legjislacioni ende nuk është plotësisht ne përputhje me Direktivat e BE-se, që është sfidë e identifikuar edhe ne Raportin e Progresit 2011, ngase ne ligjin aktual nuk është e përfshirë pjesa e dyte e direktivës 765. Per kete arsye Strategjia parasheh bashkëpunim me te mire ne shkembimin e informatave, dhe perafirm te legjislacionit relevant.

Tek Mbrojtja e Konsumatorit, sfidues mbetet fakti qe numër i vogël i konsumatoreve lajmërohen për te kërkuar ndihme, që është njeri nder treguesit kryesor se konsumatorët nuk janë te informuar mire dhe që ekziston nivel i ulet i vetëdijes. Arsyeja tjeter mund te jete mosbesimi i konsumatoreve qe rasti i tyre mund te zgjidhet nga organet kompetente. Kjo nxjerr nevojën e menjëhershme per intervenim apo shpeshtim te aktiviteteve ne vetedijesimin e konsumatorit vendas per ti adresuar parregullësitë, dhe ngritjen e efektit ne adresimin e ankesave.

2.4 Gjendja ne Tregti

Në kuadër të politikës së tregut të lirë, Qeveria e Kosovës është e përkushtuar në vendosjen e drejte te kriterëve dhe standardeve teknike për produkte dhe shërbime, te përcaktuara me marrëveshje tregtare dhe legjislacion te harmonizuar te BE-se si dhe krijimin e mekanizmave adekuate dhe me kompetence për zbatimin e tyre. Me këtë do t'i mundësohet Republikës së Kosovës për ta ngritur konkurrueshmerine ne tregun vendor dhe të jashtëm, te eliminojë barrierat e mundshme tregtare, te sigurojë mbrojtjen e jetës dhe shëndetit, konsumatorit dhe mjedisit, si dhe te behet pjese e integruar e organeve ndërkombëtare.

Ekonomia e Kosovës për dy dekada ka vuajtur nga shtypja dhe izolimi. Si pasojë e kësaj, ekonomia e Kosovës ka mbetur e pastrukturuar, me mungese te produkteve industriale, ka humbur tregun tradicional dhe ka mbetur me një force punëtore te padobishme.



Tendenca për t'u varur nga eksportet, disa nga te cilat ne te vërtetë janë industri problematike (siq është ajo e metaleve dhe e tekstilit) krijon situata te rrezikshme për tregun e punës ne shtetet e Ballkanit, kjo duke u bazuar ne synimet e natyrshme te këtyre industrive e qe synojnë te “migrojnë” ne shtetet me fuqi punëtore te lire dhe rryme (energji) te lire, siç janë shtetet e Azisë Qendrore dhe Lindore.

Sa i përket partnereve tregtarë, Kosova ka tregtuar vazhdimisht me dy blloqe te shteteve, shtetet e BE-se dhe shtetet fqinje –anëtare te CEFTA-se. Marrëdhëniet tregtare me këto grupacione te shteteve kishin uljet dhe ngritjet e tyre; ne anën tjetër, ne fund te vitit 2010 BE-ja hoqi “masat autonome” (importet pa obligime doganore me disa përjashtime) ndaj Kosovës për eksporte. Kjo u vendos ne Dhjetor te vitit 2011. Për me tepër, negociatat për Marrëveshjen te Tregtisë se Lire (MTL) mes Kosovës dhe BE-se kane ngecur për arsye politike, mirëpo, këto te fundit kane sinjale te mira për t'u filluar. Qeshtje tjetër është problemi i eksportit me Serbinë dhe Bosnjën te cilat kane nisur qe nga pavarësimi i Kosovës, ne Shkurt 2008. Pas vendosjes se masave reciproke nga Kosova ndaj Serbisë ne vitin 2011, eksportet për ne Serbi (si dhe transite ne territorin e Serbisë) kane rinisur por mbesin te vështira.

Importet qe për një vend cilësohen kritike për ekonominë e vendit dhe mirëqenies, duhet te përcaktohen me një tarife shume te ulet ose zero. Gjithashtu, sipas rregullave te OBT-se, ndalesat e importit mund te aplikohen ne raste te caktuara, duke përfshirë këtu trafikun e armeve, municionit dhe armeve qe aplikohen ne lufte materialet shpërthyes (GATT neni XXI); masat e nevojshme për zbatuar rezolutën e Kombeve te bashkuara (GATT neni XXI); masat e nevojshme për mbrojtjen e moralit ne publik (GATT neni XX); masat e nevojshme për te mbrojtur shëndetin e njeriut, kafshëve, ose jetën e bimëve (GATT neni XX); masat për mbrojtjen e pasurisë kombëtare me vlera artistike, historike, apo vlera arkeologjike (GATT neni XX); kufizimet për te ruajtur ekuilibrin e pagesave (GATT neni XII) etj. Ngajshëm, marrëveshja e CEFTA-se , Shtojca 1-Neni 18 lejon shtetet te mbrojnë interesat e tyre thelbësore te sigurisë.

Megjithë rritjen e eksporteve, qe nënkupton ndryshimin pozitiv te strukturës se tyre (defiditi tregtar ne periudhën 2001-2008 ka qenë mbi 60%), ka një rritje te vazhdueshme te importit, që në vitin 2008 ka kaluar shifren prej 2 miliardë Euro. Nje aspekt pozitiv i kesaj mund te shihet ne kalimin nga importi i mallrave te konsumit te gjere ne import te teknologjive.

Per te permiresuar me tej, struktura e tarifave ne Kosove kërkon një shqyrtim te shpejt dhe ndryshime te tarifave aktuale. Tarifat aktuale duhet te vendosen ne baze te analizave ekonomike, inputeve te palëve te interesuara si dhe përcaktimit te interesit kombëtar. Per te pasur politike te mirefilltë tarife te shkallëzuar per sektor, kerkohet nje studim i mirefilltë i sektorit qe do ti identifikonte sektoret me potencial dhe nevojë per mbeshtetje.

Dhe përfundimisht, politikat tregtare duhet aktivisht te mbështesin krijimin e një ambienti sa me miqësor për bizneset dhe investimet ne Kosove.

4 Korniza Ligjore, e Politikave dhe ajo Institucionale

4.1 Industria dhe NVM-te

Legjislacioni ne fuqi rregullon qeshtjet si, zhvillimin e Zonave Ekonomike; klasifikimin, nxitjen e krijimit dhe Zhvillimin e Ndërmarrjeve te Vogla dhe te Mesme; poashtu, kushtet dhe procedurat qe



rregullojnë regjistrimin e Patentës, Markave Tregtare, dhe Dizajnit Industrial si dhe te drejtat që rrjedhin nga regjistrimi i tyre; te drejtat themelore të Investitorëve të Huaj; Shërbimet Turistike; Tregtinë me shumicë dhe pakicë në Tregun e Brendshëm, konkurrencën e pandershme dhe masat mbikëqyrëse.

Zhvillimi i Politikave të Industrisë është në funksion të Departamentit të Industrisë. Për Regjistrimin e Bizneseve ekziston Agjencioni për Regjistrim të Bizneseve. Ndërsa në implementimin e këtyre politikave në funksion është Agjencia për Mbeshtetjen e Zhvillimit të Sektorit Privat.

Politikat e Industrisë trajtohen edhe në grupin punues për Politika Tregtare dhe 5 nën-grupet punuese, funksionet e detajzuara të tyre përmenden tek pjesa e Tregtisë.

Të Drejtat Pronësore Intelektuale në Kosovë janë të ndara në dy pjesë: 1. Të Drejtat Pronësore Industriale duke përfshirë patentat, markat tregtare dhe dizajnin industrial dhe emërtim të origjinës apo tregues gjeografik, të gjitha janë të vendosura në kuadër të Agjencisë për Pronësi Industriale (MTI) dhe 2. Të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta për të cilat përgjegjëse është Zyra për të Drejtat e Autorit Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS).

Në këtë segment thuhet edhe industria e turizmit, e cila është nën kompetencë të Departamentit të Industrisë, përkatesisht, divizionit për politika të turizmit.

4.2 Tregu i Brendshëm – Lëvizja e Lire e Mallrave

Infrastruktura e Cilësisë luan rol kyq në përmirësimin e lëvizjes së lirë të mallrave. Këtu përfshihet: Metrologjia, Akreditimi dhe Standardizimi.

Metrologjia siguron shërbime që garantojnë se pajisjet e përdorura në testime kryejnë matje të sakta. Misioni i DMK-së është që të ndërtojë një sistem të qëndrueshëm dhe kompatibil të infrastrukturës së Metrologjisë në Kosovë, me të cilin do të mundësohet ngritja e konkurrueshmërisë në tregun vendor dhe të jashtëm.

Për më tepër, *Akreditimi* si pjesë përbërëse e Sistemit të Infrastrukturës së Cilësisë në një vend, synon të sigurojë se të gjitha pjesët e Sistemit të Infrastrukturës së Cilësisë operojnë sipas standardeve përkatëse me anë të vlerësimit të kompetencës së Organeve të Vlerësimit të Konformitetit.

Standardizimi është në funksion të Agjencisë Kosovare të Standardeve dhe vepron në bazë të ligjit aktual për Standardizim.

Në funksion janë edhe 18 Komitete Teknike të cilat procedojnë standarde sipas kërkesave të palëve të treta. Poashtu, ekziston edhe Këshilli Profesional i Standardizimit.

Mbikëqyrja e tregut ka në kompetencë të inspektojë standardet e tregtimit të mallrave dhe cilësinë e shërbimeve, që ofrojnë subjektet afariste në territorin e Republikës së Kosovës.

Inspektorati i Tregut si organ përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut vepron si organ i pavarur në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Është i organizuar në formë të centralizuar, në Inspektoratin Qendror në kuadër të MTI-së, si dhe në shtatë (7) Zyra Rajonale (të cilat mbulojnë të gjitha komunat).

Ndërsa *Mbrojtja e Konsumatorit* definohet si mekanizmi institucional dhe ligjor që është në funksion të mbrojtjes së të drejtave të konsumatoreve, në veprimin e një konkurrence të drejte të tregut, dhe



tenton të sigurohet që tregu është i informuar mire dhe drejtë. Mbrojtja e Konsumatorit është e vendosur nën Departamentin për Konsumatorë. Po ashtu ekziston Keshilli për Konsumator.

4.3 Tregtia

Legjislacioni në fuqi rregullon qeshtjet si, tregtine e brendshme dhe të jashtme, masat mbrojtëse në importe, anti-dumping dhe masat kundërbalancuese. Pastaj legjislacioni për të Drejtat Intelektuale dhe Industriale, konkurrencën dhe ndihmën shtetërore, tregtinë me naftë dhe produkte të saj, tregtinë me mallra strategjike, si dhe legjislacionin doganor dhe të akcizave. Zhvillimi i Politikave Tregtare është nën fushëveprimin e Departamentit të Tregtisë (MTI)

Ndërsa, monitorimi i Politikave të Tregtisë bëhet kryesisht përmes grupeve punuese që bëjnë koordinimin e politikave tregtare, në këtë drejtim, MTI ka themeluar dhe funksionalizuar Grupin Punues për Politika Tregtare dhe 5 nën grupe punuese si: nëngrupi punues për Shërbime, Industri, Bujqësi, Lehtësimin e Tregtisë dhe Marrëveshjen Tregtare.

Në kuadër të institucioneve duhet cekur edhe organizmat të cilët kujdesen për standardin dhe kualitetin e produkteve, të njohura si Standardet Sanitare dhe Fitosanitare. Me këtë merret Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, Agjencia për Standardizim dhe Agjencia për Akreditim në kuadër të MTI-së, si dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.




5 Hapat e ardhshëm

Plani Operacional

Rekomandohet fuqishëm që posa të aprovohet kjo strategji – të fillon intensivisht zhvillimi i planit të implementimit, monitorimit dhe vlerësimit të ‘bërjes realitet’ të kësaj strategjie. Si pikënisje, mund të merret parasysh një platform gjithë përfshirëse dhe e unifikuar e planit operacional. Aneksi 4 përmban një platform të tillë, veprimet e së cilës figurativisht janë të paraqitura në vijim:

Grafikoni7 Plani Strategjik dhe Operacional i MTI-së për Zhvillimin e Sektorit Privat në Kosovë



Gjatë zhvillimit të planit strategjik, zyrtarët e lartë dhe stafi i MTI-së kanë dëshmuar një nivel të lartë të përkushtimit dhe përgjegjësisë profesionale duke mos u ndalur vetëm në pjesën strikte strategjike (‘qëllimet strategjike’ dhe ‘nën-qëllimet’), por ata gjithashtu kanë e kanë fillu planin operacional duke i zhvillu objektivat përkatësepërsecilin nën-qëllim (tabelanëvijim). Këto objektiva janë specifike, të matshme, të arritshme apo realiste, dhe të lidhura në kohë.

Tabela 4 Qëllimet Strategjike dhe Objektivat

Qëllimet Strategjike dhe Nën-qëllimet	Objektivat
---------------------------------------	------------

**FUSHA 1: Industria, Investimet dhe NVM-të****1 Shtet dhe Ndërmarrje Globalisht Konkurruese**

- | | | | |
|-----|--|-------|--|
| 1.1 | Orientimi në sektor strategjik të industrisë, duke i dhënë prioritet prodhimit dhe eksportit | 1.1.1 | Deri në fund të Q3 të vitit 2013 Qeveria e Republikës së Kosovës përcaktohet për 3 deri në 5 sektorë strategjik |
| | | 1.1.2 | Deri në fund të vitit 2014 të identifikohen dhe vendosen politikat që do të ju ofrohen ndërmarrjeve si masa stimuluese dhe nxitëse |
| | | 1.1.3 | Deri në Q2 të vitit 2014 të zhvillohen programet për përkrahjen e sektoreve strategjik |
| 1.2 | Përkrahja e vazhdueshme e zhvillimit të aftësive teknike, inovative dhe menaxheriale | 1.2.1 | Gjate periudhes 2013-2015 te ofrohen trajnime per ndermarresit ne ngritjen e aftesive teknike |
| | | 1.2.2 | Deri ne fund te vitit 2015 hapja e 3 qendrave te reja inovative |
| | | 1.2.3 | Deri ne fund te vitit 2015 krijimi i fondeve te veganta qe perkrahin idete e bizneseve inovative |
| 1.3 | Përmirësimi i vazhdueshëm i qasjes në financa | 1.3.1 | Gjate periudhes 2013-2015 te angazhohemi ne krijimin e skemave qe garantojn kredimarrjen |
| | | 1.3.2 | Gjate periudhes 2013-2015 te angazhohemi ne krijimin e skemave te granteve |
| 1.4 | Mbrojtja e pronës industriale | 1.3.2 | Deri ne fund te vitit 2015 te organizohen 6 ngjarje me karakter vetedijesues per ndermarrjet vendore, duke i informuar per rendesine e mbrojtjes se prones industriale |

2 Promovimi i Investimeve dhe Eksporteve

- | | | | |
|-----|--|-------|--|
| 2.1 | Ngritja e bashkëpunimit me komunitetin e biznesit | 2.1.1 | Stimulimi i prodhuesve vendor për të marrë pjesë në forumet biznesore dhe panaiet ndërkombëtare me qëllim të krijimit të partneriteteve biznesore. |
| | | 2.1.2 | Publikimi i katalogut të produkteve vendore me qëllim të promovimit të produkteve jashtë vendit përmes organizimeve të ndryshme dhe ambasadave të Kosovës. |
| | | 2.1.3 | Krijimi i brendit të Kosovës për kualitet “Quality of Kosovo” që ka për qëllim identifikimin e produkteve me kualitet të lartë. |
| | | 2.1.4 | Bashkëpunimi me bizneset e Diaspores për të eksportuar produktet Kosovare në vendet ku Diaspora Shqiptare është e madhe. |
| 2.2 | Rritja e aktiviteteve në promovimin e investimeve brenda dhe jashtë vendit | 2.2.1 | Deri ne fund të vitit 2015, organizimi i 21 forumeve biznesore dhe 10 vizitave të targetuara për promovim të investimeve |
| | | 2.2.2 | Pjesëmarrje në 6 evenimente ndërkombëtare për promovimin e investimeve |
| | | 2.2.3 | Avancimi i përpjekjeve për të promovuar Kosovën tek Diaspora Shqiptare |
| | | 2.2.4 | Nënshkrimi i 10 Memorandumeve të bashkëpunimit me Agjenci për Promovimin e Investimeve me shtetet që vlerësohen të kenë potencial investues në Kosovë |



		2.2.5	Publikimi i 5 materialeve të reja promovuese dhe azhurnimi i të gjitha materialeve promovuese aktuale si dhe përpilimi i 3 studimeve sektoriale të sektorëve me potencial për të thithur investime
2.3	Monitorimi i mbarvajtjes së investimeve të huaja	2.3.1	Gjate periudhës 2013-2015 të vizitohen rregullisht të gjithë investitorët e huaj me qëllim të kujdesit ndaj tyre.
		2.3.2	Gjate periudhës 2013-2015 të organizohen 3 trajnime teknike me qëllim të përmirësimit të shërbimit ndaj investitorëve të huaj dhe bizneseve vendore.
2.4	Mbrojtja e Investitorëve të Huaj	2.4.1	Deri në fund të vitit 2015 të nënshkruhen 10 marrëveshje bilaterale për mbrojtje dhe promovim të investimeve
		2.4.2	Trajnime të Grupit Punues për negociimin e marrëveshjeve bilaterale për mbrojtje dhe promovim të investimeve nga ekspert të huaj.

FUSHA 2: Lëvizja e Lirë e Mallrave

3 Zhvillimi i mëtejshëm i Infrastrukturës së Cilësisë

3.1	Zhvillimin e mëtejshëm të metrologjisë ligjore dhe industriale	3.1.1	Deri në fund të vitit 2015 rritja e mbikëqyrjes së metrologjisë duke u fokusuar në metrologjinë e arit, energjisë elektrike dhe naftës.
		3.1.2	Deri në fund të vitit 2015 të merren masat e duhura me qëllim të ruajtjes së etaloneve kombëtare
3.2	Rritja në vazhdimësi e TVK-ve të akredituara	3.2.1	Nga 2012 deri në 2015 të rritet për 70% numri i TVK-ve
		3.2.2	Nga 2012 deri në 2015 të rritet për 150% numri i aplikacioneve të TVK-ve për akreditim
3.3	Sigurimi i kontinuitetit të plotësisë të kërkesave të standardeve	3.3.1	Nga 2013 deri në 2015 ofrimin e 70 mbikëqyrjeve të TVK-ve të akredituara
		3.3.2	Nga 2013 deri në 2015 raporti TVK të akredituara vs. TVK të pa-akredituara të rritet respektivisht nga 10/90 % në 20/80 %
		3.3.3	Nga 2013 deri në 2015 të ofrohen 20 trajnime mbi zbatimin e standardit ISO 17020 dhe ISO 17025
		3.3.4	Nga viti 2013 deri në 2015 të organizohen së paku 3 ngjarje promovuese mbi rëndësinë e standardeve dhe akreditimit ku sigurohet pjesëmarrja e së paku 200 pjesëmarrësve relevantë
3.4	Rritja e numrit të standardeve të miratuara dhe ngritja e vetëdijes në implementimin e tyre.	3.4.1	Nga 2013 deri në 2015 raporti i standardeve të miratuara si SK në raport me standardet evropiane në fuqi të rritet respektivisht nga 22.5/77.5 % në 60/40 %
		3.4.2	Nga 2013 deri në 2015 raporti në mes standardeve të harmonizuara dhe atyre të adoptuara si SK të rritet respektivisht nga 40/60 % në 70/30 %
		3.4.2	Nga viti 2013 deri në 2015 të organizohen së paku 6 ngjarje promovuese mbi rëndësinë e standardeve ku sigurohet pjesëmarrja e së paku 400 pjesëmarrësve relevant

4 Siguria e Produkteve industriale jo-ushqimore



- | | | | |
|-----|--|-------|--|
| 4.1 | Ngritjen e vetedijës së konsumatorëve | 4.1.1 | Deri në fund të vitit 2013 do të kemi një sistem efektiv të adresimit të ankesave |
| | | 4.1.2 | Nga viti 2013 deri në fund të vitit 2015 të shtohet numri i tryezave, debateve dhe publikimeve, në lidhje me ngritjen e vetëdijësimit për mbrojtjen e konsumatorit |
| 4.2 | Mbikqyrje të tregut, përkatësisht produkteve industriale që qarkullojnë në tregun vendor | 4.2.1 | Deri në fund të vitit 2014 harmonizimi me legjislacionin relevant të BE-së, për inspektoratin dhe mbrojtjen e konsumatorit |
| | | 4.2.2 | Gjatë periudhës 2013-2015 të punohet në ngritjen e bashkëpunimit, duke menduar në atë ndër-institucional, rajonal, me sektorin privat dhe shoqërinë civile |

FUSHA 3: Politikat Tregtare

5 Zhvillimi i Politikave Tregtare në drejtim të përmirësimit të bilancit tregtar të vendit

- | | | | |
|-----|---|-------|---|
| 5.1 | Përkrahja e sektorëve me potencial eksportues | 5.1.1 | Deri në fund të vitit 2013, identifikimi i sektorëve prioritar, me kapacitet eksportues duke përdorur një model kuantitativ ekonomik |
| | | 5.1.2 | Deri në Q3 të vitit 2014, rishikimi i politikave tregtare dhe vendosja e një pakete të tillë që është e shkallëzuar dhe i stimulon ato me potencial eksportues |
| | | 5.1.3 | Deri në Q2 të vitit 2014 identifikimi i 3 deri 5 tregjeve potenciale për kompanitë kosovare |
| | | 5.1.4 | Deri në Q4 2013 identifikimi dhe vendosja e një sistemi të analizave kualitative dhe kuantitative me qëllim të përpilimit të politikave tregtare në harmoni me potencialin ekonomik aktual, dhe që hartimi i politikave tregtare të jetë i bazuar në evidencë |
| 5.2 | Liberalizimi i tregut dhe zbatimi i marrëveshjeve për tregti të lirë | 5.2.1 | Deri në fund të vitit 2015 liberalizim i pjesës më të madhe të produkteve industriale, këtë me BE-në, CEFTA dhe vendet e treta |
| 5.3 | Antarësimi në organizatat relevante për tregti, duke i dhënë prioritet OBT-së | 5.3.1 | Deri në fund të vitit 2013 aplikimi për antarësim në OBT |
| | | 5.3.2 | Deri në fund të vitit 2015 adresimi i pjesës më të madhe të kërkesave që dalin nga OBT |